REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax:+355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. **Prot.** **Tiranë ___/___/2015**
Nr. Dok. 201500281/4

Lënda: *Rekomandojmë kryerjen e hetimeve të plota, objektive dhe të gjithanshme për rastin e keqtrajtimit fizik të shtetasit B. K. nga disa punonjës të Komisariatit të Policisë Kavajë, P. M., I. B., F. B. dhe R. D., për veprën penale të veprimeve arbitrare në bazë të nenit 250 e 25 të K.Penal.*

Drejtuar : **Z. Artan MADANI**
Drejtues i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor

KAVAJË

***I nderuar zoti Madani*,**

Institucioni i Avokatit të Popullit ka regjistruar me iniciativë rastin e bërë publik ditët e fundit në median vizive ku rezulton që një punonjës policie i Komisariatit të Policisë Kavajë ka goditur disa herë me shqelm në fytyrë një shtetas i cili ishte duke u shoqëruar prej krahësh nga dy punonjës të tjerë policie.

Në datën 23.02.2015 nga punonjësit e institucionit tonë janë kryer verifikime dhe hetime administrative në vend në lidhje me ngjarjen e ndodhur dhe të publikuar në një videon private dhe të transmetuar në TV 24 NEW.

Nga verifikimet e kryera në Komisariatin e Policisë Kavajë u informuam se, shtetasi i keqtrajtuar nga punonjësit e policisë në këtë rast dhe pikërisht në datën 19.02.2015 quhet B. K. Ky shtetas është banor i qytetit Kavajë dhe ka qënë person në kërkim nga policia, si i dyshuar për kryerjen e veprës penale të vjedhjes së pronës në bashkëpunim, të mbetur në tentative, parashikuar nga neni 134/2 e 22 të K.Penal. Shërbimet e Policisë së Komisariatit Policisë Kavajë, kanë organizuar disa punonjës policie për gjetjen e tij, mbajtjen nën kontroll dhe kapjen në një moment të përshtatshëm me qëllim kryerjen e veprimeve procedurale dhe vënien para përgjegjësisë penale konform ligjit.

Me datën 19.02.2015, rreth orës 11.30', punonjësit e policisë e kanë zbuluar vendin e ndodhjes së këtij personi dhe kanë marrë masa për kapjen dhe shoqërimin e tij në ambientet e Komisariatit të Policisë Kavajë. Shtetasi B.

K. ka qënë duke udhëtuar me një automjet tip benz me ngjyrë të zezë dhe e ka kuptuar se ai po ndiqej për t'u kapur nga policia. Për t'i shpëtuar policisë ai ka tentuar të largohet dhe t'u shmanget forcave policore dhe gjatë ecjes së tij indietro ka goditur një nga makinat private të punonjësve të policisë. Në këtë moment kanë ndërhyrë dy nga punonjësit e policisë duke e kapur atë me forcë prej krahësh me qëllim shoqërimin e tij në Komisariatin e Policisë. Shtetasi në fjalë nuk i është bindur urdhrit të tyre dhe ka tentuar me forcë të largohet prej tyre.

Në ndihmë të punonjësve të policisë ka shkuar edhe shefi i sektorit të rendit Nënkomisar P. M., i cili ka kryer veprime në kundështim me ligjin duke e goditur shtetasin B. K. disa herë me shqelm në fytyrë, moment ky që është filmuar nga një video private. Pasi është shoqëruar forcërisht në komisariat, shtetasi B. K. është ndaluar në dhomat e sigurisë në Komisariatin e Policisë Kavajë dhe materialet përkatëse i janë referuar organit të Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Kavajë. Në rastin konkret shtetasi B. K. është ndaluar nga organet e policisë si person i dyshuar për kryerjen e veprës penale të vjedhjes së pronës në bashkëpunim të mbetur në tentativë, në bazë të nenit 134/2 dhe 22 të K.Penal.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë me vendimin e datës 22.02.2015 ka vendosur të vlerësojë të ligjshëm ndalimin e shtetasit B. K. për veprat penale të parashikuara në bazë të neneve 134/2 e 22 dhe 242 të K.Penal dhe ka caktuar ndaj tij si masë sigurimi atë të detyrimit për t'u paraqitur në Policinë Gjyqësore 1 herë në muaj, dhe lirimin e menjihershëm të tij nga dhomat e sigurisë së Komisariatit të Policisë Kavajë.

Ne konstatojmë se veprimi i kryer nga punonjësi i policisë P. M. ndaj shtetasit B. K. duke e goditur me shqelma në fytyrë nuk është në përputhje me rregullat e parashikuara në aktet normative në fuqi të cilat rregullojnë veprimtarinë e Policisë së Shtetit.

Sjellim në vëmendje së, në bazë të nenit 118 të Ligjit Nr. 9749, datë 04.06.2007 "Për Policinë e Shtetit", *punonjësit e policisë kanë të drejtën e përdorimit të forcës fizike ndaj personave, të pajisjeve, të mjeteve të tjera apo të armëve të zjarrit. Përdorimi i forcës mbi personat është veprimi i drejtpërdrejtë nëpërmjet forcës fizike, pajisjeve, mjeteve të tjera apo armëve të zjarrit. Punonjësi i Policisë përdor forcën për të përmbushur një synim të ligjshëm vetëm kur kjo është e nevojshme dhe vetëm nëse të gjitha masat e tjera janë të pasuksesshme apo të pamundura. Punonjësi i Policisë përdor nivelin minimal të forcës së nevojshme, në përputhje me parimin e përpjesëtueshmërisë. Punonjësi i Policisë përzgjedh nivelin e nevojshëm të forcës ndërmjet mundësive të përshkallëzuara që, ndër të tjera, përfshijnë bindje me fjalë, shtrëngim fizik, mjete goditëse, mjete me lëndë kimike paralizuese, mjete me goditje elektrike, qen policie dhe armë zjarri.*

Në rastin në shqyrtim, goditja disa herë me shqelm në fytyrë nga punonjësi i policisë P. M. nuk përbën ushtrim force në bazë të akteve normative në fuqi, por ushtrim dhune duke cënuar rëndë të drejtën e shtetasit B. K., atë të integritetet fizik të tij. Ky veprim përmban elementët e veprës penale të "Kryerjes së veprimeve arbitrare", të parashikuar nga neni 250 i Kodit Penal.

Gjithashtu, ky veprim cënon rëndë edhe imazhin e Policisë së Shtetit dhe dëmton e trondit besimin e publikut tek ky organ.

Ndërkohë nga komunikimi i punonjësve tanë me ju u infomuam se për këtë ngjarje në datën 20.02.2015 organi juaj ka filluar kryesisht procedimin penal Nr. 72/2015 për veprën penale të "Kryerjes së veprimeve arbitrare" të parashikuar nga neni 250 dhe 25 i Kodit Penal.

Duke ju falenderuar për qëndrimin e mbajtur deri tani lidhur me këtë rast, bazuar në nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku parashikohet se: *"Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave të njeriut, nga administrate publike",* dhe në nenin 21/ç të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", ku thuhet se*: "i rekomandon prokurorisë të fillojë hetime në qoftë se vëren se është konsumuar figura e një vepre penale;",*

R E K O M A N D O J M Ë :

Kryerjen e hetimeve të plota, objektive dhe të gjithanshme për rastin e keqtrajtimit fizik të shtetasit B. K. nga disa punonjës të policisë Kavajë, shefi i rendit Nenkomisar P. M., inspektorit I. B.,inspector F. B. dhe K/inspektor R. D. për kryerjen e veprës penale të veprimeve arbitrare parashikuar nga nenet 250 e 25 të K.Penal.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni ndaj këtij rekomandimi, lutemi të na ktheni përgjigje brenda 30 ditëve konform nenit 22 të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit".

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj***,**

AVOKATI I POPULLIT

Igli TOTOZANI